



Pranuar / Dorezuar Prijeto / Predato Received / Delivaty	20.10.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSUCK	6354/2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKË QYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.773/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2626/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.773/2021 të datës 27.08.2021 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat kundër Vendimit dhe Vendimit KD.Nr.05/2021 të datës 06.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.773/2021 e datës 27.08.2021 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, më datë 27.08.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4421/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.10/2021 të datës 03.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Vendimit KD.Nr.05/2021 të datës 06.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.08.2021 ka proceduar kërkesën e



ankuesit për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 28.09.2021 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat ndërlidhur me këtë çështje ankimore.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokollit 4978/2021 të datës 11.10.2021 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 15.09.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2626/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të datës 11.10.2021 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit me A.nr.773/2021 të datës 27.08.2021.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 4421/2021 të datës 27.08.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.Nr.10/2021 të datës 03.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Autorizimin e datës 24.08.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.08.2021; Përgjigjen në ankese e datës 28.09.2021; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit DBNJ/DPSKPK/901/2021 i datës 01.05.2021; Përshkrimi i detyrave të punës Zyrtar Ligjor 2, LI/060; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 16.12.2020, 11.12.2019; Vërejtje me shkrim e datës 12.10.2020 për ankuesen; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 22.02.2021; Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor datës 02.03.2021; Vendimin KD.Nr.04/2021 i datës 22.03.2021 i Komisionit Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 06.06.2021; Mesazhe telefoni; Emailin e datës 06.05.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 06.05.2021 nga ankuesja për \_\_\_\_\_ Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor datës 10.05.2021; Vendimin KD.Nr.05/2021 i datës 01.06.2021 i Komisionit Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën e datës 23.06.2021 nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Certifikatën Shëndetësore me numër CM 0201 e datës 16.06.2021; Vendimin KA.Nr.05/2021 të datës 01.07.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimit KD.Nr.05/2021 të datës 06.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën e datës 28.07.2021 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Shkresa nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës për ankuesen e datës 28.06.2021, 02.06.2021; Njoftimin e datës 11.10.2021 për ankuesen; Aktgjykimin A.nr.2626/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Emailin e datës 20.09.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ dhe përgjigjen e datës 29.09.2022 nga \_\_\_\_\_

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.773/2021 të datës 27.08.2021, *sepse:*





Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesja sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit me numër DBNJ.DPSKPK/901/2021 të datës 01.05.2021 është e punësuar në pozitën *Zyrtare Ligjore* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë në cilësi të mbikëqyrëses së ankueses më datë 06.05.2021 parashtron kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses, për shkak së e njëjta edhe pse i është tërhequr disa herë vërejtja e njëjta vazhdon të dërgoj mesazhe të kryeprokurori, prokuroret dhe zyrtaret tjerë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke shfaqur gjendjen emocionale të saj, mesazhe këto që nuk lidhen asgjë me punën por që janë të natyrës personale.

Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër KD.Nr.05/2021 të datës 06.07.2021, ka shpallur ankuesen përgjegjëse për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 6 nën paragrafi 1.16 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat e Disiplinore në Shërbimin Civil dhe nenin 12 paragrafi 1 të Kodit të Etikës Profesionale për Nëpunësit Mbështetës, duke shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore *"Largim nga zyra dhe transferim në Prokurorinë Themelore në Prizren me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në një (1) vit"*.

Ankuesja kundër vendimit të Komisionit Disiplinor me datë 28.07.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër KA.Nr.10/2021 të datës 03.08.2021 ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.Nr.10/2021 të datës 03.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Vendimit me numër KD.Nr.05/2021 të datës 06.07.2021 të Komisionit Disiplinor, pretendon së Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk përmban elementet qenësore të një vendimi sepse të njëjtit i mungon pjesa arsyetuese, ndërsa Komisioni Disiplinor nuk ka cekur arsyen pse ankuesja duhet të transferohej në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe së a janë përmbushur kriteret ligjore për një transfer të ankues kështu që mbi këtë bazë ky vendim është diskriminues dhe hakmarrës dhe i pa mbështetur në prova, fakte dhe i pabazuar. Propozon që Këshilli ta anuloj vendimin e Komisionit Disiplinor dhe ankuesen ta kthej në vendin e saj të punës si *Zyrtare Ligjore* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat materiale të siguruara gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështje juridike-administrative, ka konstatuar së Vendimi KD.Nr.05/2021 i datës 06.07.2021 i Komisionit Disiplinor përmes të cilit ankueses i është shqiptuar masa disiplinore *"Largim nga zyra dhe transferimi Prokurorinë Themelore në Prizren me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në një (1) vit"*, është bërë i plotfuqishëm nga data 13.10.2021 rrjedhimisht nga kjo datë ankuesja është transferuar në Prokurorinë Themelore në Prizren, andaj duke qenë së masa disiplinore është shqiptuar në kohëzgjatje prej një viti atëherë rezulton së masa disiplinore ka qenë e zbatueshme nga data 13.10.2021 deri më datë 12.10.2022 përkatësisht masa disiplinore ka pushuar me kalimin e periudhës një vjeçare të transferimit, kështu që nisur nga kjo rrethanë faktike Kolegji i Këshillit konstaton së në këtë fazë të shqyrtimit, objekti ankimor për të cilin ankuesja ka filluar procedimin administrativ është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje dhe rrjedhimisht qëllimi i ankesës mbi bazën e fakteve si me lartë është bërë i pamundur. Andaj, në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,





Kolegji vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës së ankueses me numër A.Nr.773/2021 të datës 27.08.2021.

Lidhur me efektet juridike të masës disiplinore sipas nenit 67 paragrafi 2 nënparagrafi 1.2.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji konstaton se me përfundimin e periudhës së transferimit të përcaktuar me vendimin e Komisionit Disiplinor nëpunësi/ja civil/e i/e transferuar duhet të kthehet në vendin e tij të punës që ka ushtruar para transferimit si masë disiplinore.

Theksuar si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm/L mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.773/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses, Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

